



6/10 KBU
17.5.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ERZEN

VENDIM

Nr.5, datë 30/04/2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR NËNTOKËSOR (PUS-SHPIMI 3/ALB) PËR QËLLIME
INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT "K.I.D - ALB" SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë "K.I.D - ALB" sh.p.k, "Kërkesë për leje për përdorim të burimit ujor nëntokësor për qëllime industriale" (Fabrika e tullave), me vendndodhje, Maminas, Bashkia Shijak, Qarku Durrës.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit 3/ALB (KRGJSH)

-X= 466089.39;

Y= 4581366.96;

Z=20.57 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar: $Q=0.17$ l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 60 m

Thellësia e vendosjes së pompës : 30 m

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

-X= 466081.34; Y= 4581339.13; Z=20.57 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ERZEN

AFRIM QËNDRO

